



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT

**RAPORT I PUNËS SË
PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT
PËR VITIN 2019**

SHKURT, 2020

PËRMBAJTJA E RAPORTIT**I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019**

- Lufta kundër korrupsionit
- Lufta kundër krimit të organizuar
- Respektimi I të drejtave të njeriut
- Bashkëpunimi ndërinstitucional
- Respektimin e të drejtave të njeriut;
- Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktima;
- Bashkëpunimin ndërinstitucional;
- Bashkëpunimin ndërkombëtar;
- Përdorimin e metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive;
- Zbatimi I rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2018”, miratuar datë 20.06.2019 nga Kuvendi I Shqipërisë;
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave “për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019” miratuar me vendimin nr.296, datë 10.05.2019;
- Raportim mbi zbatimin e të gjithë Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre;
- Informacion statistikor mbi çështjet penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ;
- Problematikat e hasura;

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË PËR VITIN 2019

- Volumi i punës në hetim;
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë;
- Treguesit kryesorë të punës së Prokurorisë Mat për vitin raportues;
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale;
- Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror;
- Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë;
- Kriminaliteti sipas peshës (numrit më të madh të procedimeve) së veprave penale;
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime-kundërvajtje).

III. ANALIZA KRAHASIMORE 2 VJEÇARE E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

- Treguesit statistikore për numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të regjistruar, numrin e të pandehurve dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve të dënuar.

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË MAT PËR VITIN 2019

- Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve;
- Të dhëna për gjykimet e posaçme;
- Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve;
- Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit;
- Të dhëna për të pandehurit e mitur;
- Të dhëna për pasojat e veprave penale.

V. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

- Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë);
- Letërporositë (letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letërporositë për jashtë);
- Njohjet e vendimeve penale (njohjet e vendimeve penale të huaja, njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit);
- Transferimet e procedimeve penale (transferimet e procedimeve nga jashtë, transferimet e procedimeve për jashtë);
- Transferimet e personave të dënuar (transferimet e personave të dënuar nga jashtë, transferimet e personave të dënuar për jashtë);
- Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.

VI. TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME

I- DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019

Viti 2019, për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat ka qenë viti i një angazhimi të gjithëanshëm, në funksion të realizimit të detyrave kushtetuese që ka Prokuroria, si organ i ndjekjes penale. Ngarkesa që kemi përballuar këtë vit, treguesit që kemi shënuar në të gjitha drejtimet e ndjekjes penale dhe në përfaqësimin e akuzës në gjykim, flasin për punë me ndjenjë të lartë përgjegjësie, nga të gjithë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore dhe administrata e kësaj prokurorie.

Në këtë raport, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat si organ i ndjekjes penale analizon veprimtarinë e punës së periudhës 1-vjeçare për vitin 2019, gjendjen e kriminalitetit në territorin ku ushtron veprimtarinë e saj, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushtetuese si institucion dhe prokurorëve që përfaqësojnë atë, arritjet, problemet dhe mangësitë e evidentuara si dhe përcaktimin e prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për rritjen e performancës në veprimtarinë e saj në të ardhmen.

Gjatë vitit 2019, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat e ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore si Zbatimi I rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2018”, miratuar datë 20.06.2019 nga Kuvendi I Shqipërisë dhe mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019” miratuar me vendimin nr.296, datë 10.05.2019 të Këshillit të Ministrave si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu siç edhe do të analizohet në vijim të këtij raporti është bazuar në një angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar njëkohësisht urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

➤ 1.1 :Në luftën kundër korrupsionit.

Në fokus të veprimtarisë së punës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat ka qenë lufta dhe ndëshkimi i korrupsionit dhe kriminimit të organizuar si fenomene të përhapura që kanë qenë pengesë në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Kështu në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat për vitin 2019 nuk ka patur asnjë rast të referuar për veprën penale të korrupsionit sipas nenit 259 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike” .

Në vitin 2019 nga KLSH-ja është referuar një material për veprën penale të „Shkeljes së barazisë në tendera apo ankande publike“,parashikuar nga neni 258 i K.Penal.Ky procedim është dërguar për kopetencë prokurorisë kopetente.

Në vitin 2019 Janë referuar nga Policia e Shtetit, nga individë dhe subjekte të tjera, 11 raste materialesh kallëzuese dhe një procedim penal i ardhur për kopetencë, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, gjithsej 12 materiale nga 16 në vitin 2018.Nga këto materiale kallzuese janë regjistruar 5 procedime penale dhe për 7 raste është vendosur mosfillim procedimi.

Për 5 procedime penale mënyra e përfundimit ka qenë në 3 raste i është kërkuar gjykatës pushimi i çështjes dhe për dy raste është vendosur moskompetenca e kalimi i akteve prokurorisë kompetente. Në krahasim me vitin 2018 ka patur tendencën në rënie e referimeve për këtë veprë penale.

➤ **1.2:Lufta kundër krimit të organizuar**

Nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat janë marrë të gjitha masat për forcimin e bashkëpunimit me policinë gjyqësore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese me qëllim shkëmbimin e informacionit, për rritjen e efektivitetit të hetimeve për marrjen e masave parandaluese e konkretisht në rritjen e cilësisë së hetimit për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike.

Për vitin 2019 kemi një rritje të numrit të procedimeve penale të regjistruar për veprat penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, Ndërsa në vitin 2018 nuk kemi pasur asnjë rast të regjistrimit të procedimit për këtë veprë penale. Në vitin 2019 numri i procedimeve të regjistruara është 9 raste, por për dy raste kemi patur bashkime procedimesh dhe numri aktual është 7, gjatë hetimit të tyre janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren teknikat speciale të hetimit (hetimit proaktiv) kemi arritur në zbulimin dhe identifikimin e disa prej autorëve , për 1 rast çështja është dërguar për gjykim me një të pandehur me masë sigurimi personal “Arrest me burg”, në 3 raste është vendosur pezullimi i hetimeve dhe 3 raste vazhdojnë të jenë në hetim në vitin 2020 me 4 persona nën hetim me masë sigurimi personal “Arrest me burg” Nga ana e Prokurorisë për një rast i është kërkuar gjykatës caktimi i masave të sigurimit personal “Arrest me burg” në mungesë dhe në bashkëpunim me policinë e shtetit është bërë e mundur ekzekutimi i masë të sigurimit personal për këtë të dyshuar. Në të gjitha rastet për hetimin dhe zbulimin e autorëve të kryerjes së veprës penale sa sipër janë përdorur metodat speciale të hetimit të cilat janë në proces.

Gjitashtu për këtë vit kemi të regjistruar dhe dy çështje për veprën penale “Pastrim të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, për një rast i është kërkuar gjykatës pushim procedimi dhe një rast është në hetim.

Për të përmirësuar më tej performancën në të gjithë treguesit e saj do të fokusohemi në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritjen e profesionalizmit të prokurorëve, fuqizimin e pavarësisë së institucionit si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese.

Në mënyrë të përmbledhur drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit gjatë vitit 2019 kanë qenë:

➤ **1.3:Respektimi i të drejtave të njeriut**

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka patur si përparësi në veprimtarinë e saj respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e këtyre të drejtave në rastin e cënimit të tyre si dhe mbrojtjen e të drejtës së pronës private dhe publike nga veprimet e paligjshme etj, duke bashkëpunuar edhe me institucionet e tjera vendore dhe qendrore me qëllim hetimin e veprave penale në këtë fushë në kohë sa më të shpejtë dhe parandalimin e pasojave kriminale. Respektimi i të drejtave të ligjshme të qytetarëve dhe mbrojtja e lirive themelore të tyre duke garantuar në çdo rast procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor është detyrim kushtetues i Prokurorisë.

Në ato raste kur nga ana e policisë është urdhëruar shoqërimi i shtetasve të ndryshëm, subjekte të veprave penale sipas grupeve dhe personave të ndryshëm menjëherë ju është vënë në dispozicion një avokat, lista e të drejtave të dyja palëve. Gjithashtu për personat e mitur në konflikt me ligjin apo si dëshmitar në ngjarje, për të gjitha rastet ka qene asistimi i psikologut, madje dhe i prindit apo mësuesit të personit të mitur në disa raste.

Të drejtat janë respektuar si gjatë hetimeve paraprake dhe në mënyrë të veçantë në zbatimin e kushteve dhe kriterëve ligjore në kërkimet për caktimin e masave të sigurimit dhe të dënimit, duke u nisur nga parimi i ligjshmërisë dhe proporcionalitetit.

Të miturit dhe grupet vulnerabël si të pandehur dhe viktima

Një kujdes i veçantë i është kushtuar trajtimit të të miturve dhe grupeve të tjera vulnerabël në kërkimet alternative në Gjykatë. Në trajtimin e këtyre grupeve kemi respektuar parashikimet dhe rregullimet që bën ligji procedural penal.

Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal për të Mitur me 1 janar të viti 2017, ndjekja e procedimeve penale me të mitur ka pësuar ndryshime të rëndësishme procedurale, si për sa i takon kompetencës për hetimin e këtyre procedimeve, ashtu edhe mënyres së trajtimit të viktimave dhe të pandehurve të mitur, të drejtat që atyre duhet tu respektohen, masat e sigurimit që aplikohen ndaj të pandehurve të mitur, procedurës së gjyqimit të të pandehurve të mitur dhe dënimet ndaj tyre. Tani jemi në një situatë, e cila para së gjithash kërkon njohje të mirë të Kodit Penal për të Mitur, me qëllim që të mund të përshtasim koncepte dhe praktika të drejta dhe ligjore në ndjekjen e procedimeve me të mitur.

Në vitin 2019 në strukturën organike të Prokurorisë Mat është shtuar pozicioni i kordinatorit i cili ka një rol të domosdoshëm në procesin penal.

Në vitin 2019 janë regjistruar gjithsej 6 procedime penale +2 të mbartura me 8 persona të dyshuar të mitur ose viktimë e veprës penale persona të mitur, të moshës nga 14-18 vjeç, për veprat penale penale kryesisht “Drejtimit mjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 I K. Penal, “Shkelje të rregullave të Qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 I K. Penal; për dy procedime është vendosur moskompetenca e hetimit dhe aktet i janë dërguar për hetime të mëtejshme prokurorisë Tiranë, Seksionit të Miturve, ndërsa për 3 procedime me 4 të pandehur janë dërguar për gjykim, 1 nga të cilat me gjykim të drejtëpërdrejtë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, një rast i cili ka përfunduar gjyqimi dhe është aplikuar dënimi me burg sipas nenit 59 të Kodit Penal, tre rastet e tjera mbarten në gjykim në vitin 2020.

Ndërsa një procedim penal mbartet në hetim me dy persona njeri prej të cilëve është në grup moshën 16-18 vjeç.

Është siguruar pjesëmarrja e psikologut dhe e mbrojtësit në rastet e shoqërimeve, arrestimeve dhe veprimeve të para me të mitur, për të respektuar maksimalisht të drejtat e tyre në procesin penal. Janë njoftuar prindërit dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, në respektim të ligjit dhe zbatimi i parimit të interesit më të lartë të të miturit

Në mënyrë të veçantë prioritet ka qenë dhe rritja e efektivitetit të hetimit të veprave penale të kryera ndaj fëmijëve, martesës dhe familjes. Referuar vitit 2018 ka patur trend në rënie vepra penale e “Dhunës në familje”. Në vitin 2019 janë regjistruar 8 çështje për veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal me të gjithë paragrafët e saj. Nga këto, 8 çështje me 8 të pandehur, 8 arrest në burg janë dërguar për gjykim në 7 raste dhe janë gjykuar te gjitha rastet, nga shtatë raste të dërguara për gjykim pesë raste nga ana e prokurorisë janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë, masa e dënimit për të gjitha rastet ka qenë me burg. Për një rast Prokuroria

ka vendosur pushim çështje ,miratuar nga Gjykata pasi në momentin e kryerjes së veprës penale sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, autori ka rezultuar i sëmurë dhe veprën e ka kryer për shkak të sëmundjes. Siç dhe konstatohet, këto çështje janë hetuar me përkushtim e përparësi nisur nga vetë natyra e veprës penale pasi siç u përmend dhe më sipër nga shtatë raste të dërguara për gjykim në pesë raste është aplikuar gjykimi i drejtëpërdrejtë.

➤ **1.4: Bashkëpunimi ndërinstitucional**

Raporti me Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës

Gjatë vitit 2019, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë disa urdhëra dhe udhëzime, zbatimi i të cilëve ka qenë në fokus të prokurorëve me qëllim mbarëvajtjen e punës së prokurorisë dhe zbatimin korrekt të ligjit penal procedural. Këto urdhëra dhe udhëzime janë punuar me oficerë të policisë gjyqësore dhe administratën e prokurorisë në mbledhjet periodike që zhvillohen, ju është dhënë përparësi e precedencë “Udhëzimit nr.47 datë 14.09.2018”Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale...”, udhëzimit nr.03 datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe proced.neë prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”, është punuar raporti i monitorimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbi informimin e subjekteve të të dhënave personale në kuadër dhe të Marrëveshjes së bashkëpunimitndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr.113/2019, Udhëzimi nr.05 datë 30.07.2019 “Për mardhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” etj.

Bashkëpunimi me Komisaratin e Policisë Mat, Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër dhe të tjera.

Nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat janë marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me policinë e shtetit dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese në funksion të hetimit të specializuar të shpejtë e të gjithanshëm në goditjen e grupeve kriminale me rrezikshmeri të lartë shoqërore, kryesisht të grupet kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimin kundër korrupsionit dhe atij financiar.

Në forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjensitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare në funksion të hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave janë kryer analiza të përbashkta për procedime të veçanta me policinë e shtetit.

Në rritjen e bashkëpunimit me oficerët e policisë gjyqësore të të gjitha agjensive ligjzbatuese me qëllim udhëheqjen, mbikëqyrjen, kryerjen e analizave periodike në funksion të rritjes së cilësisë së kryerjes se veprimeve hetimore dhe dokumentimit të tyre.

Në rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore për hetimin e veprave penale.

Bashkëpunimi me Komisaratin e Policisë Mat dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër ka qenë shumë i ngushtë për një qëllim të përbashkët, parandalimin e krimeve, evidentimin e tyre, vënien e

autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimin e tyre sipas ligjit me qëllim parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të policisë vendore. Kështu nga 341 kallëzime në total të regjistruara për vitin 2019, peshën më të madhe të referimeve prej 280 (82 %) e zënë referimet e kryera nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Mat dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Nga këto kallëzime 280 pasqyruar në të dhënat statistikore sipas grup veprave perkatese, gjithashtu rezultoi se 30 materiale kallëzuese pa kualifikim ligjor janë raportuar për vlerësim, si largim nga banesa, mbyetje, vdekje nga infarkti etj., janë referime të Policisë së Shtetit.¹ Më tej janë kryer 28 kallëzime nga shtetasit, referime nga nëpunësit publikë janë 2 referime të kryera nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje/ Politikë të tjera dhe 28 raste mbi ankimin e të dëmtuarve, nga të cilat 19 kanë ardhur nga policia. Një kujdes i veçantë i është kushtuar dhënies së udhëzimeve dhe detyrave për oficerët e policisë gjyqësore në strukturat e policisë së shtetit, që u është deleguar vendimi për kryerje veprimesh hetimore për hetimin e çështjeve penale të referuara nga ana e tyre. Gjithashtu ata janë njohur edhe me kuadrin ligjor të ndryshuar të ligjit penal-procedural.

Lidhur me referimet që policia e shtetit sjell për fakte dhe ngjarje të kallëzuara nga shtetas të ndryshëm, vlerësojmë se është e nevojshme që kallëzimet e shtetasve të referohen në Prokurori pasi të plotësohen me veprimet e nevojshme hetimore dhe procedurale. Këtë problem e kemi diskutuar rast pas rasti në takimet me drejtuesit e strukturave të policisë gjyqësore dhe me oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Mat, duke sugjeruar plotësimin me veprimet e nevojshme të materialit para se ai të referohet në prokurori. Plotësimi me veprimet e nevojshme hetimore i materialit që referohet në prokurori, **së pari:** është detyrim procedural për oficerin e policisë gjyqësore pasi ai duhet të konkludojë dhe të krijojë bindje se fakti që kallëzohet ka ndodhur, **dhe së dyti:** materiali i plotësuar me veprimet e nevojshme hetimore i jep mundësi prokurorit të konkludojë me zgjidhje të shpejtë ligjore, siç është ajo e mosfillimit në rastet kur rezultojnë kushtet ligjore për këtë zgjidhje, apo të regjistrojë menjëherë procedimin dhe të orientojë shpejt kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore. Në këtë mënyrë do të shmangeshin zvarritjet e panevojshme në trajtimin e materialeve të referuara dhe në dhënien e zgjidhjeve ligjore të shpejta dhe të bazuara në ligj dhe në prova.

Raporti me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat

Bashkëpunimi me Gjykatën ka qenë korrekt dhe i mbështetur në pavarësinë e secilit organ publik. Prokurorët kanë qenë korrekt me paraqitjen e tyre në seancat gjyqësore si përsa i përket etikës ashtu edhe përfaqësimit të çështjeve. Nuk ka patur raste të evidentuara nga ndonjë gjyqtar në lidhje me sjelljen, etikën, paraqitjen apo përfaqësimin e akuzës nga ana e prokurorëve në Gjykatë. Është koordinuar puna në rastet e trajnimit të përbashkët të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Raporti me institucionet të tjera

¹ Nga këto kallëzime, 297 pasqyruar në të dhënat statistikore sipas grup veprave perkatese, dhe se 30 materiale kallëzuese janë referuar pa kualifikim ligjor, për vlerësim, si largim nga banesa, mbyetje etj dhe 10 materiale janë bashkuar me procedime apo kallëzime në vitin 2019 dhe se 4 materiale janë regjistruar procedime penale në vitin 2020. gjithsej 341 materiale kallëzuese të regjistruara në vitin 2019..

Një bashkëpunim reciprok ka patur edhe me institucionet e tjera vendore dhe qendrore, si me Zyrën Përmbartimore, Zyrën e Shërbimit të Provës Mat, IEVP Burrel, etj për nxjerrjen në kohë të urdhërave të ekzekutimit të vendimeve penale nga ana e prokurorit, për mbikqyrjen në vazhdimësi të ekzekutimit dhe zbatimit të dënimeve penale, kohën e provës, etj. Vetëm për vitin 2019 janë nxjerrë 51 urdhëra ekzekutimi, nga të cilat 11 urdhëra ekzekutimi me burgim, 3 urdhëra ekzekutimi me gjobë, 28 urdhëra ekzekutimi me dënime alternative N.59, dhe 9 urdhër ekzekutimi në aplikim të neneve 63 të Kodit Penal punë në interes publik dhe 64 Kodit Penal për lirim para kohe me kusht. Statistikat mbi konkretizimin e urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga prokurori konkludojnë në: ekzekutimin e 11 urdhër ekzekutimeve për dënime me burg, 1 urdhër ekzekutime për dënime me gjobë, 12 urdhër ekzekutim në referencë të nenit 59 të K.Penal, 9 urdhëra ekzekutimi në referim të nenit 63 të K.Penal dhe 2 urdhër ekzekutim në referencë të nenit 64 K.Penal për lirim para kohe me kusht.

Institucionet e tjera kanë qenë bashkëpunuese, duke u kthyer përgjigje në kohë kërkesave të organit të prokurorisë së funksion të hetimit të procedimeve penale, etj. Janë organizuar takime me faktorët e tjerë për sensibilizimin e opinionit për të dhënë ndihmën e duhur në parandalimin e veprave penale në marrëdhëniet familjare, në ndikimin pozitiv të grupeve vulnerabël, sidomos të miturve për të mos kryer vepra penale, etj.

➤ **1.5: Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore ndërkombëtare është arritur nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Siç u përmend dhe më sipër, prokurorët kanë qenë korrektë dhe të shpejtë në ekzekutimin e letër-kërkesave të ndryshme të autoriteteve të huaja gjyqësore, si në njoftimin e dëshmitarëve, njoftimin e të pandehurve, njoftimin e vendimeve penale të gjykatave të huaja, etj.

Për vitin 2019 nuk ka patur asnjë kërkesë për ekstartim.

➤ **1.6: Përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimet proaktive**

Gjatë vitit 2019, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat janë evidentuar dhe rritur dukshëm rastet e përdorimit të teknikave të posaçme të hetimit sipas Kodit të Procedurave Penale siç dhe janë përgjimet ambjentale, telefonike etj, ndërsa në referim të neneve 294/a dhe 294/b, veprimet stimuluese dhe agjentët e infiltruar këto veprime pothuajse mungojnë. Në disa çështje janë kryer përgjime të telekomunikimeve dhe në disa prej tyre ka patur rezultate të mira në interes të hetimit, për vitin 2019 i është kërkuar gjykatës 13 procedime kërkesa për lejim përgjimi, zgjatje afati lejim përgjimi, raste të cilat janë miratuar nga ana e gjykatës dhe përdorimi i tyre ka sjellë efikasitet duke rritur zbulueshmërinë e disa veprave penale. Në të ardhmen mendojmë se do të intensifikohet puna në drejtim të përdorimit të këtyre metodave speciale të hetimit, duke qenë se krimi i organizuar dhe krimi në përgjithësi po avancohet dhe po bëhet më konspirativ.

➤ **1.7: Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre**

Puna në organin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat për vitin 2019 ka qenë në fokus dhe në angazhimin maksimal për zbatimin e Rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2018”, miratuar datë 20.06.2019 nga Kuvendi I Shqipërisë dhe zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave “për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019” miratuar me vendimin nr.296, datë 10.05.2019

Krahasuar me vitin 2018, gjendja e kriminalitetit për veprat e rënda penale si vrasjet, ka pësuar rënie, por problematike këtë vit është bërë përhapja e veprave të: “Kultivimit të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal; “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga Neni 199/a të Kodit Penal, “Mbajtje pa leje e armëve e munic. luftarake”, parashikuar nga Neni 278 i Kodit Penal dhe një rast i shënuar për veprën penale “Vjedhje me armë”, parashikuar nga neni 140 i Kodit penal. Veprat penale sa përmenda më lart janë vepra të cilat në vitin e kaluar ishin të zeruara ndërsa këtë vit është shënuar regjistrimi i një numri të konsiderueshëm të tyre.

Natyrisht që për disa grup veprash penale ka një tendencë në rënie të , rol të rëndësishëm ka luajtur dhe respektimi i rekomandimeve të përvitshme të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit dhe krimit të organizuar si dhe urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm. Duke patur parasysh sa më sipër, organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat ka punuar me profesionalizëm, përkushtim e korrektësi ligjore për të përmbushur me sukses detyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq, mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale dhe detyra të tjera që ligji i ngarkon asaj.

Në mënyrë periodike i është dërguar informacion Prokurorisë së Përgjithshme në kuadër të zbatimit të Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave „Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019“.

➤ **1.8 :Informacion statistikor mbi çështjet penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve**

Viti 2019 ka qenë vit zgjedhor dhe për vitin 2019 ka të regjistruar tre procedime penale për veprat penale të parashikuara nga Kreu X i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (nenet 325-332/a), janë regjistruar tre procedime penale të cilët me vendim për bashkim procedimi janë bashkuar në një procedim të vetëm , procedim i cili është dërguar për gjykim me 15 persona të pandehur 8 prej të cilëve me masa sigurimi personal, ndërsa për 7 persona, 3 prej të cilëve me masë sigurimi personal, i është kërkuar gjykatës pushimi i hetimeve. Është regjistruar një kallëzim penal i ardhur nga Bashkia Mat ndaj KZAZ-se, nr 16 Burrel, për zaptim të objekteve pronë të Bashkisë Mat. Gjate fazes së vlerimit te materiali eshte konkluduar se nuk ka elemnete te ndonje vepre penale per te cilin duhet te filloj ushtrimi i ndjekjes penale, vendimrrja ju eshte komunikuar shkreserisht kallezuesi, dhe nuk ka patur procedure ankimim.

➤ **1.9 :Problematikat e hasura.**

Një problematikë e evidentuar në raport me Policinë, pra shërbimet e Policisë Gjyqësore janë lëvizjet e shpeshta të oficerëve. Ka raste të zëvendësimit në një procedim penal të oficerëve të Policisë Gjyqësore. Kjo për shkak të lëvizjeve të shpeshta nga një sektor në tjetrin, ka raste që

dosjet janë sjellë në prokurori pas një muaji nga lëvizjet, pa relacion, etj. Materiale procedurale të referuara jashtë afatit 5 ditor në rastet kur nuk ka materiale të sekuestruara dhe jashtë afatit 2 ditor në rastet kur kemi materiale të sekuestruara.

Janë të shpeshta rastet kur nuk respektohet afati i lënë nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore, ku në lidhje me këtë problematikë është kërkuar rritja e kontrollit nga prokurori që delegojnë kryerjen e veprimeve hetimore. Ajo që duhet evidentuar si mangësi është mos trajtimi i rasteve të shkeljeve duke kaluar në procedim disiplinor oficerët e policisë gjyqësore. Gjatë dinamikës së punës në hetimin e çështjeve shpesh evidentojmë të meta dhe mangësi, që janë trajtuar duke tërhequr vëmendjen.

Aadministrimi i akteve të ekspertimit në shumë raste vonojnë dhe nuk kryhen në kohë,pra administrimi i tyre në dosje sjellë vonesa dhe zvarritje në hetim.

Gjithashtu një problematikë është dhe mospasja e një infrastrukture të nevojshme për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”,mospasja e kësaj infrastrukture shpesh herë na çon në vonesa për kryerjen e veprimeve të para procedurale .

II- ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT PËR VITIN 2019

2.1 Volumi i punës në hetim për vitin 2019

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, gjatë vitit 2019 janë trajtuar 341 materiale kallëzuese/referuese që përbën një rënie ,në krahasim me vitin 2018 gjatë të cilit janë regjistruar 363 materiale kallëzuese/referuese. Janë ndjekur gjithsej 225 procedime penale nga të cilat 31 të rifilluara,ka një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2018 me 6 procedime më shumë, në të cilin janë ndjekur 219 procedime penale nga të cilat 24 të rifilluara. Janë mbartur nga viti 2019 për në vitin 2020 gjithsej 18 procedime, nga 17 procedime penale që ishin mbartur nga viti 2018².

Nga 341 materiale kallëzuese është vendosur mosfillimi për 150 referime dhe kallëzime penale të vitit 2019 krahasuar me 191 kallëzime të mosfilluara gjatë vitit 2018.

Volumi i punës në hetim i organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat për vitin 2019 paraqitet si vijon:

Lloji i Procedimeve Penale	Numri i procedimeve	Persona nën hetim	Të pandehur	Të arrestuar
Procedime të mbartura nga 2018	17	4	7	5
Procedime penale të regjistruara	172	46	74	43
Rifilluar të pushuara	0	0	0	0
Rifilluar të pezulluara	31	0	0	0
Ardhur me transferim	5	1	1	0
TOTALI	225	51	82	48

² Janë ndjekur gjithsej 225 procedime penale ne v.2019, nga te cilat 172 rishtazi nga Prokuroria Mat, 5 te ardhura nga Prokurori te tjera,31 te rifilluara,të mbartura 17 çështje nga viti 2018,pra gjithsej 225 .

Krahasimi i statistikave të dy viteve të fundit

Vitet	Kallëzime të regjistruara	Procedime të mbartura	Procedime të regjistruara	Rifilluar/ Transferuar	Ndjekur procedurat në hetim
2018	363	23	166+6=172	24/15	219
2019	341	17	172+5=177	31/7	225

Nga 225 procedime të vitit 2019 u është dhënë zgjidhje 207 procedimeve me 33 persona nën hetim, me 82 të pandehur dhe 39 të arrestuar, si vijon:

- **Pushime:** 77 procedime penale me 25 persona në hetim, me 4 persona me masa sigurimi personal, nga 77 çështje të pushuara 31 janë çështje të rifilluara e të pushuara për shkak të kalimit të afateve të ndjekjes penale, krahasuar me 66 procedime penale nga të cilat 24 të pushuara për shkak të kalimit të afateve të ndjekjes penale në vitin 2018.
- **Pezullime:** 58 procedime janë pezulluar për shkak se pas hetimit të kryer për këto procedime penale nuk është bërë e mundur të identifikohej autorët e veprave penale nga këto procedime në një rast është pezulluar për shkak të sëmundjes pasi autori i kryerjes së veprës penale është i sëmurë ,krahasuar me një vit më parë numri i procedimeve të pezulluara ka pësuar një rritje të lehtë, kjo zgjidhje ligjore është vendosur për 8 procedime penale më shumë, pasi gjatë vitit 2018 pezullimi i hetimeve është vendosur për 50 procedime penale.
- **Transferime:** Për 7 procedime penale me 7 persona nën hetim dhe 3 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Për këto raste prokurorët kanë konstatuar moskompetencën për hetimin e tyre prandaj dhe kanë vendosur transferimin në prokuroritë kompetente.
- **Dërguar në Gjyq:** Gjatë vitit 2019, prokurorët kanë vendosur dërgimin në gjykatë për 65 procedime me 82 të pandehur dhe 32 me masa sigurimi personal, kundrejt 71 procedimeve penale të dërguara në gjykatë gjatë vitit 2018 me 83 të pandehur dhe 37 persona me masa sigurimi personal. Në vitin 2019 janë dërguar për gjykim 6 çështje më pak krahasuar me vitin 2018 por pavarësisht numrit më të vogël të procedimeve penale të dërguara në gjykatë numri i personave të pandehur ,që ju është ngritur akuzë ka qenë afërsisht sa në vitin 2018 pra në vitin 2019, ju është njoftuar akuza 82 personave kundrejt 83 personave në vitin 2018.
- **Mbeten në hetim çështje të vitit 2019 në vitin 2020**
18 procedime me 18 persona nën hetim nga të cilët 9 persona me masa sigurimi personal.

Janë gjykuar gjatë vitit 2019

- 67 çështje me 71 të pandehur nga të cilët 33 persona me masa sigurimi personal.
- mbeten në gjykim 27 procedime me 43 të pandehur, nga të cilët 16 persona me masa sigurimi personal.

2.2 Çështje të përfaqësuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat

Gjatë vitit 2019 nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka ngritur dhe përfaqësuar akuzë në Gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 94 procedime penale me 114 të pandehur, 46 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Krahasuar me vitin 2018, gjatë të cilit u përfaqësuan në Gjykatë 82 procedime penale me 95 të pandehur, 46 persona me masë sigurimi personal. Rezultojnë 12 procedime dhe 19 të pandehur më shumë se një vit më parë për rrjedhojë ngarkesa e përfaqësimit në vitin 2019 për prokuror ka qenë më e lartë se një vit më parë pasi që nga muaji Shtator 2019 ,gjykimi dhe hetimi është ndjekur dhe përfaqësuar nga një prokuror i vetëm.

Janë gjykuar gjithsej gjatë vitit 2019 saktësisht 67 çështje penale me 71 të pandehur, 34 prej të cilëve me masa sigurimi personal. Ndërkohë gjatë vitit 2018 janë gjykuar 51 çështje penale me 62 të pandehur, 34 prej të cilëve me masa sigurimi personal.

Gjithashtu janë paraqitur në Gjykatë 43 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal, nga të cilat 22 prej tyre me “Arrest në burg“, 9 me “Arrest në burg në mungesë“, 1 “Arrest në burg me afat“,6 me „Arrest shtëpie“ dhe 5 raste me “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore“. Në rastet kur nga gjykata është vendosur masë sigurimi e ndryshme nga ajo e kërkuar nga prokurori është bërë ankim.

2.3 Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë për vitin 2019

Procedime penale të regjistruara

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019 janë regjistruar rishtazi 177 procedime penale, krahasuar me 172 çështje të regjistruara në vitin 2018, fakt i cili tregon se gjendja e kriminalitetit është pothuajse në nivelin e vitit 2018,por në vitin 2019 është rritur numri i çështjeve të regjistruara për veprën penale të „Kultivimit të Bimëve narkotike“,parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe është regjistruar një rast për veprën penale të „ vjedhjes me armë“,parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal, gjithashtu vihet re një rritje e procedimeve penale të regjistruara për veprën penale „Ndërtim i paligjshëm“parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

Mosfillimet

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2019, është vendosur mosfillimi për 150 referime dhe kallëzime penale nga 191 të vitit 2018.(Sqarojm se nga te dhenat statistikore rezultojn gjithsej 120 mosfillime në vitin 2019 dhe 147 në vitin 2018). Ky tregues shpjegohet ndër të tjera,pasi ka materiale të cilat regjistrohen dhe nuk kanë elementë te veprave penale siç janë largimet nga banesa,vdekjet aksidentale etj.që në vitin 2019 janë vendosur për 30 raste të tilla me vendim mosfillimi(120 raste sipas statistikës +30 raste pa vepra=150).

Pushimet e çështjeve

Gjatë vitit 2019, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur pushimin për 77 procedime penale nga të cilat 31 te rifilluara, 10 çështje më shumë krahasuar me vitin 2018 gjatë të cilit u vendos pushimi për 66 procedime penale nga të cilat 24 të rifilluara. Në të gjitha këto procedime penale përgjithësisht janë kryer veprime hetimore të plota dhe në çdo rast është bërë njoftimi i vendimit të pushimit si kallëzimitarëve, institucioneve, apo individëve dhe palëve të interesuara.

Duke iu referuar statistikës për grup, veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi rezultojnë se është vendosur pushimi si vijon:

- Për veprat penale kundër jetës së personit të parashikuara nga nenet 76-133 të Kodit Penal janë pushuar 13 çështje gjatë vitit 2019 dhe peshën kryesore në këtë grup veprash e përbën vepra penale e „vetëvrasjes“ me 6 raste, kundrejt 11 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2018.
- Për veprat penale kundër pasurisë të parashikuara nga nenet 134-200 të Kodit Penal janë pushuar 39 çështje gjatë vitit 2019, kundrejt 31 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2018.
- Për veprat penale kundër mjedisit, rendit, sigurisë publike dhe zgjedhjeve të lira, të parashikuara në nenet 201-332/a të Kodit Penal janë pushuar 25 çështje kundrejt 24 çështjeve të pushuara gjatë vitit 2019.

Procedimet penale të pezulluara

Është vendosur pezullimi i hetimeve në bazë të nenit 326 të Kodit të Procedurave Penale për 58 procedime penale , 8 procedime më shumë se në vitin 2018 gjatë të cilit janë pezulluar 50 procedime penale. Evidenca e pezullimeve të procedimeve penale e ndarë sipas grup veprave është si vijon:

- Për veprat penale kundër jetës së personit të parashikuara nga nenet 76-133 të Kodit Penal është pezulluar 1 procedim penale gjatë vitit 2019, aq sa në vitin 2018.
- Për veprat penale kundër pasurisë, mjedisit të parashikuara nga nenet 134-207 të Kodit Penal janë pezulluar 47 procedime penale gjatë vitit 2019, kundrejt 43 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2018.
- Për veprat penale kundër rendit, sigurisë publike dhe zgjedhjeve të lira, të parashikuara në nenet 235/1-332/a të Kodit Penal janë pezulluar 10 procedime penale gjatë vitit 2019, kundrejt 6 procedimeve penale të pezulluara gjatë vitit 2018.

Siç vihet re, procedimet penale të pezulluara që zënë një peshë të konsiderueshme janë procedimet e veprave penale kundër pasurisë. Këto procedime janë kryesisht me vendngjarje të referuara nga seksionet e Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Mat dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Në të gjitha rastet është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore, si dhe janë deleguar veprime të posaçme dhe në përfundim bazuar dhe në relacionin e oficerëve të policisë gjyqësore është vendosur pezullimi i hetimeve.

Për pjesën tjetër të procedimeve është vendosur pezullimi i hetimeve për veprat penale të „mbajtjes pa leje të armëve luftarake“, „Kultivim bimësh narkotike“ etj. Siç e kemi përmendur dhe më herët është vendosur pezullim i procedimi për një rast me autorë të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale për kryerjen e veprës penale „Mashtrim në sigurime“, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, pasi autori është i sëmure i papergjeshëm para ligjit, konkluduar me akt ekspertimi mjeko-ligjor. Gjatë vitit 2019 ka patur një trend në rritje numri i procedimeve penale të pezulluara krahasuar me një vit më parë.

Krimi pa autor shoqërohet me impakt të rëndë shoqëror, ai përcjell mosbesim tek organet e rendit dhe të ndjekjes penale, si dhe pasiguri sociale për jetën dhe pronën. Me këtë vlerësim duhet gjykuar treguesi i pezullimit të hetimeve të vendosura gjatë vitit 2019 me 58 procedime penale të pezulluara.

Rritja e zbulueshmërisë së autorëve të veprave penale kërkon përmirësimin e punës me procedimet penale pa autor. Nga prokurorët kërkohet që të orientojnë më mirë dhe më drejt hetimin, duke përcaktuar detyra dhe veprime konkrete, nga ana e prokurorëve këtë vit është rritur numri i çështjeve duke përdorur teknikat speciale të hetimit gjë që ka sjellë dhe zbulueshmërinë e autorëve të veprave penale në disa raste, por prokurori duhet të ndjekë edhe vetë disa prej veprimeve që kërkojnë njohuri dhe profesionalizëm, si dhe duke aplikuar më shumë hetime proaktive.

Por, natyrisht që rritja e zbulueshmërisë kërkon edhe angazhim më të mirë të strukturave të policisë gjyqësore që janë në terren, që të ushqejnë hetimin me të dhëna dhe fakte në vijimësi dhe të mos ngelen vetëm në kuadrin e të dhënave të siguruara nga veprimet e para hetimore.

Procedimet penale të transferuara

Është vendosur transferimi për kompetencë për 7 procedime penale me 7 persona nën hetim me 3 persona me masë sigurimi personal. Për një rast është bërë konflikt kompetence nga prokuroria pritëse dhe nga Prokuroria e Përgjithshme është caktuar kompetente prokuroria pritëse. Ndërsa për rastet e tjera nuk ka patur konflikt kompetence .

Çështjet penale të dërguara për gjykim për vitin 2019

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat 65 çështje me 82 të pandehur, 32 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Krahasuar me vitin 2018, gjatë të cilit u dërguan në Gjykatë 71 procedime penale me 83 të pandehur, 37 prej të cilëve me masë sigurimi personal, rezultojnë 6 çështje më pak megjithatë numri i të pandehurve është pothuajse i njëjtë.

Duke iu referuar veprave penale për të cilën janë akuzuar dhe dërguar për gjykim të pandehurit, statistikat e detajuara rezultojnë si vijon:

- Për veprën penale **të vrasjes me dashje, vrasje me paramendim dhe vrasje të cilesuara, të** parashikuar nga nenet 76,78/1,79/dh ,79/ë të K.Penal .Për vitin 2019 nuk është dërguar asnjë procedim penal për gjykim për këtë kategori veprash penale, krahasuar me vitin 2018 që janë dërguar për gjykim 4 procedime penale me 5 të pandehur të gjithë me masë sigurimi personal arrest në burg.
- Për veprën penale të **kanosjes, plagosjes së rëndë e plagosjes së lehtë me dashje, përndjekjes** të parashikuar nga nenet 84 dhe 88,89,121/a/1 të Kodit Penal janë dërguar në Gjykatë 5 procedime penale gjatë vitit 2019, me 5 të pandehur dhe 3 me masë sigurimi personal arrest me burg, Dërguar në gjyq aq sa në vitin 2018.
- Për veprën penale **të dhunës në familje** ,parashikuar nga nenet 130/a,1,2, 130/a,4 të Kodit Penal janë dërguar për gjykim 7 procedime penale, katër raste me gjykim të drejtëpërdrejtë me 7 të pandehur, 7 me masë sigurimi personal arrest me burg, kundrejt 8 procedimeve në vitin 2018, pra 1 procedime më pak se në vitin 2018.
- Për veprën penale të **vjedhjes** të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal janë dërguar në gjyq vetëm 1 procedime me 1 të pandehur, 1 arrest me burg. Viti 2018 shënon 3 procedime penale të dërguara në gjyq.

- Për veprën penale të *vjedhjes së energjisë elektrike* të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal është dërguar për gjykim 1 procedim penal me 1 të pandehur, 1 me masë sigurimi detyrim paraqitje, dërguar, aq sa është dërguar dhe në vitin 2018.
- Për veprën penale të *marshtrimit në sigurime* të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 3 procedime penale me 3 të pandehur ndërsa në vitin 2018 janë dërguar 5 procedime penale me 5 të pandehur.
- Për veprën penale të *shkaterrimit të pronës* të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal kemi dërguar për gjykim 2 procedime me 3 të pandehur, aq sa dhe në vitin 2018.
- Për veprën penale të *Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare*, parashikuar nga neni 182/a, të Kodit Penal kemi dërguar për gjykim 1 procedime me 1 të pandehur ndërsa në vitin 2018 nuk kemi patur asnjë rast.
- Për veprën penale të *fallsifikimit të dokumentave*, të parashikuar nga neni 186, i K. Penal, janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 2 të pandehur, kundrejt 3 procedimeve në vitin 2018.
- Për veprën penale të *ndërtimit të paligjshëm* të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal janë dërguar në Gjykatë për 10 procedim penale me 10 person të pandehur, kundrejt 1 rasti për vitin 2018.
- Për veprën penale të *mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik*, të parashikuar nga neni 242 të K. Penal janë dërguar në Gjykatë 1 procedime penale me 2 persona të pandehur, kundrejt 2 rasteve për vitin 2018.
- Për veprën penale të *shpërdorimit të detyrës*, të parashikuar nga neni 248 të K. Penal është dërguar në Gjykatë vetëm 1 procedim penal me 1 persona të pandehur, me masë sigurimi personal „arrest në burg“, aq sa në vitin 2018.
- Për veprat penale të *prishje e qetësisë publike*, të parashikuar nga nenet 274 i Kodit Penal janë dërguar në Gjykatë 1 procedime penale me 1 persona të pandehur, ndërsa në vitin 2018 nu ka patur asnjë rast.
- Për veprën penale të *vetëgjyqësisë*, parashikuar nga neni 277 të K. Penal janë dërguar në Gjykatë 1 procedime penal me 1 person të pandehur, aq sa në vitin 2018.
- Për veprën penale të *mbajtjea pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*, parashikuar nga nenet 278, të K. Penal janë dërguar në Gjykatë 2 procedime penale me 3 persona të pandehur, 2 me masë sigurimi personal „arrest me burg“, kundrejt 4 procedimeve në vitin 2018.
- Për veprën penale të *shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive*, parashikuar nga neni 282 të K. Penal është dërguar në Gjykatë 1 procedime penal me 1 person të pandehur, aq sa në vitin 2018.

- Për veprën penale të *Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*, parashikuar nga neni 283 Kodit Penal është dërguar për gjykim 1 procedim penal me 1 të pandehur, 1 arrest me burg, kundrejt 2 procedimeve në vitin 2018.
- Për veprën penale të *Kultivimit të bimëve narkotike*, parashikuar nga neni 284 Kodit Penal është dërguar për gjykim 1 procedim penal me 1 të pandehur, 1 arrest me burg, ndërsa në vitin 2018 nuk ka patur asnjë rast.
- Për veprat penale të *Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor e drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt* parashikuar nga nenet 290 e 291 të Kodit Penal janë dërguar për gjykim 17 procedime me 18 të pandehur, 6 prej të cilëve me masë sigurimi personal, aq sa në vitin 2018, por në vitin 2019 janë dërguar me gjykim të drejtëpërdrejtë 6 raste.
- Për veprën penale të *humbja e dokumentave sekrete* parashikuar nga neni 296 i Kodit Penal është dërguar për gjykim vetëm 1 procedim penal, ndërsa në vitin 2018 nuk kemi patur asnjë rast.
- Për veprën penale të *kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror* parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal është dërguar për gjykim me Urdhër penal 1 procedim penal, aq sa në vitin 2018.
- Për veprën penale të *pengimit të ekzekutimit të vendimeve të gjykatës*, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 1 procedime penale me 1 persona të pandehur, ndërsa në vitin 2018 ka patur 2 procedime.
- Për veprën penale të *largimit të burgosurit nga vendi i qëndrimit*, parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal është dërguar për gjykim 1 procedime penale me 1 persona të pandehur, ndërsa në vitin 2018 ka patur asnjë rast.
- Për veprën penale të *futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim*, parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal është dërguar për gjykim 1 procedime penale me 1 persona të pandehur, ndërsa në vitin 2018 nuk ka patur asnjë rast.
- Për veprën penale të *dëmtimit me dashje i materialit zgjedhor*, parashikuar nga neni 326/a/1 i Kodit Penal është dërguar për gjykim 1 procedime penale me 15 persona të pandehur, 8 prej të cilëve me masa sigurimi personal, ndërsa në vitin 2018 nuk ka patur asnjë rast.

Pjesën më e madhe të këtyre veprave penale e përbëjnë veprat penale të vjedhjes me 38 procedime të reja penale të regjistruara. Një shqetësim mbetet jo vetëm numri i madh i kësaj vepre penale, por edhe figura e kësaj vepre penale që kohët e fundit është bërë mjaft e larmishme për nga objekti material. Gjatë vitit 2019 është regjistruar një numër i konsiderueshëm procedimesh penale me objekt vjedhjen e bagëtive, të koshereve të bletëve etj. Numri i procedimeve penale të pezulluara për moszbulim të autorit të veprës penale vazhdon të jetë shumë i lartë, pavarësisht se këtë vit ka pësuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin e kaluar.

Por, ndërsa vjedhja është krimi me përhapje më të madhe, por me tendencë në rënie, zbulueshmëria e autorëve të kësaj vepre penale është mjaft e ulët. Për këtë vepër në vitin 2019 rezulton të ketë 2 raste pushim procedimi, me një persona nën hetim, pushuar për shkak se autori i dyshuar sipas aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor është person me probleme të shëndetit mendor. Përgjithësisht, procedimet për këtë vepër penale relatohen në Prokurori pa autor, apo pa dyshime konkrete për

autorë të mundshëm. Edhe nga hetimi më pas nuk sigurohen të dhëna për autorët e veprave penale, dhe në përfundim të hetimeve, relatohet pezullimi i procedimeve penale për moszbulim të autorëve.

Në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës sipas viteve janë si në tabelë:

VIT I	Regjistruara/mbartura/Rifilluar	Derguar ne gjyq	Pushuar	Pezuluar	Transferuara	Ne hetim	
2016	211+43 mbartura+107 Rifilluara	101	73+107 Rifill	62	6	8	168
2017	191+8 mbartura+76 Rifilluara	50	47+74 Rifill.	74	6	23	178
2018	172+23mbartura+24 Rifilluara	71	42+24 Rifill	50	15	17	147+44
2019	177+17mbartura+31 Rifilluara	65	46+31 Rifill.	58	7	18	120+30

2.4 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale

Gjatë vitit 2019, të dhënat në lidhje me njoftimet e veprave penale paraqiten si më poshtë: Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të policisë vendore. Kështu nga 341 kallëzime në total të regjistruara për vitin 2019, peshën më të madhe të referimeve prej 280 (82 %) e zënë referimet e kryera nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Mat dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Nga këto kallëzime 280 pasqyruar ne te dhenat statistikore sipas grup veprave perkatëse, gjithashtu rezulton se 30 materila e kallezueze pa kualifikim ligjore janë referuar për vleresim, si largim nga banesa, mbytje, vdekje nga infarkti etj, janë referime të Policisë së Shtetit.³ Më tej janë kryer 28 kallëzime nga shtetasit, referime nga nëpunësit publikë janë 2 referime të kryera nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje/ Policinë të tjera dhe 28 raste mbi ankimin e të dëmtuarve, nga të cilat 19 kanë ardhur nga policia. Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të policisë vendore. Kështu nga 341 kallëzime në total të regjistruara për vitin 2019, peshën më të madhe të referimeve prej 280 (82 %) e zënë referimet e kryera nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Mat dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Nga këto kallëzime 280 pasqyruar ne te dhenat statistikore sipas grup veprave perkatëse, gjithashtu rezulton se 30 materila e kallezueze pa kualifikim ligjore janë referuar për vleresim, si largim nga banesa, mbytje, vdekje nga infarkti etj, janë referime të Policisë së Shtetit.⁴ Më tej janë kryer 28 kallëzime nga shtetasit, referime nga nëpunësit publikë janë 2 referime të kryera nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje/ Policinë të tjera dhe 28 raste mbi ankimin e të dëmtuarve, nga të cilat 19 kanë ardhur nga policia.

2.5 Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror

³ Nga këto kallëzime, 297 pasqyruar ne te dhenat statistikore sipas grup veprave perkatëse, dhe se 30 materiale kallezueze jane referuar pa kualifikim ligjore, per vleresim, si largim nga banesa, mbytje etj dhe 10 materiale jane bashkuar me procedime apo kallzime ne vitin 2019 dhe se 4 materiale janë regjistruar procedime penale në vitin 2020. gjithsej 341 materiale kallzuese të regjistruara në vitin 2019..

⁴ Nga këto kallëzime, 297 pasqyruar ne te dhenat statistikore sipas grup veprave perkatëse, dhe se 30 materiale kallezueze jane referuar pa kualifikim ligjore, per vleresim, si largim nga banesa, mbytje etj dhe 10 materiale jane bashkuar me procedime apo kallzime ne vitin 2019 dhe se 4 materiale janë regjistruar procedime penale në vitin 2020. gjithsej 341 materiale kallzuese të regjistruara në vitin 2019..

Nga ana Prokurorisë është kërkuar caktim mase sigurimi personal ndaj 43 personave, ku për 22 persona është kërkuar masa e sigurisë “Arrest në burg” sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale; për 9 persona “Arrest në burg në mungesë”; për 1 persona “Arrest në burg me afat”; për 6 persona „arrest shtëpie“,parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe për 5 persona “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” sipas nenit 234 të Kodit të Procedurave Penale ,ndërsa „garanci pasurore“ sipas nenit 236 të K.Pr.Penale nuk është kërkuar për asnjë rast.

Nga ana e Gjykatës është vendosur për 17 persona masa e sigurimit “Arrest në burg”; për 9 persona “Arrest në burg në mungesë”; për 3 person “Arrest me afat”;për 6 person „arrest në shtëpi“; si dhe për 8 persona masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore“ dhe asnjë rast për „garanci pasurore“. Tabela dhe grafiku vijues paraqesin në mënyrë të përmbledhur të dhënat:

Lloji i masës	Arrest në burg	Arrest në shtëpi	Arrest në burg me afat	Në mungesë/garanci	Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore	TOTALI
Prokurori	22	6	1	9	5	43
Gjykata	17	6	3	9	8	43

2.6 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Në vitin 2019 janë nxjerrë urdhëra për ekzekutim për 51 vendime penale të formës së prerë sipas të dhënave statistikor.

Nga këto:

- 28 vendime kanë patur disponim me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim
 - 3 vendime kanë patur disponim me dënim me gjobë
 - 11 vendime kanë patur disponim me dënim me burgim
 - 4 vendime kanë patur disponim për lirim para kohe me kusht
 - 5 vendime kanë patur disponim për pezullimin e ekzekutimit me burgim e detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik
- Gjithashtu janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi për:
- 2 vendime kanë patur disponim rivlerësim e caktim mase mjekësore
 - 30 vendime kanë patur disponim për shpenzimet proceduriale
 - 5 vendime kanë patur disponim për kthim prove materiale

Viti	URDHËRA EKZEKUTIMI						
	Burg	Gjobë	Neni 59	Neni 63+64	Rivlerism masa mjekësore	Shpenzime proceduriale	Prova Materiale
2019	11	3	28	4+5	2	30	5
TOTALI	51				37		

Në vitin 2019 janë ekzekutuar 35 vendime penale

- 12 vendime kanë patur disponim me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim
- 1 vendime kanë patur disponim me dënim me gjobë
- 11 vendime kanë patur disponim me dënim me burgim
- 9 vendime disponim dënim alternativ, punë në interes publik
- 2 vendime disponim lirim para kohe me kusht

Viti	VENDIME TË EKZEKUTUARA						
	Burg	Gjobë	Neni 59	Neni 63+64	Rivlerism masa mjekësore	Shpenzime procedurale	Prova Materiale
2019	11	1	12	9+2	2	30	5
TOTALI	35				37		

2.7 Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat

Sa i përket shtrirjes territoriale, kriminaliteti ka patur tendencë të shtrirjes në njësitë administrative të Bashkisë Mat dhe asaj Klos, bazuar në materialet e referuara nga Komisariati i Policisë Mat. Kjo vjen si rezultat i gjendjes social-ekonomike të banorëve të kësaj njësie, papunësisë së lartë, prurjeve të reja demografike nga zonat rurale, të cilat janë zhvendosur në qytet për kushte më të mira jetese, Prurjet e reja kanë sjellë së bashku me problemet ekonomike dhe sociale dhe tendencën në rritje të treguesve të kriminalitetit.

2.8 Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre

Në lidhje me tendencën e kriminalitetit, të përhapjes së veprave penale në përgjithësi, apo me grup veprash penale të veçanta rezultojnë se veprat penale me një shtrirje dhe përhapje më të madhe janë ato kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike me 79 dhe 2 të ardhura me transferim për kompetencë, gjithsej 81 procedime penale.

Evidentojmë se për nenet 134/1/2-142 të Kodit Penal janë regjistruar 40 procedime penale kundrejt 38 procedime në vitin 2018, këtu vlen të theksojmë kthimin e një fenomeni të hershëm atë të vjedhjes me armë, parashikuar nga Neni 140 i K. Penal, regjistruar një procedim penal; për nenet 143-149 të Kodit Penal janë regjistruar 3 procedime penale, kundrejt 6 të regjistruara në vitin 2018; për nenet 150-162 të Kodit Penal janë regjistruar 13 procedime penale aq sa ka patur dhe në vitin 2018 por në këtë grup veprash shihet një tendencë në rritje e veprës penale „Shkatërrim prone me zjarr“, parashikuar nga neni 151 i K. Penal, regjistruar 7 raste; për nenet 180-182/a të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal ndërsa në vitin 2018 nuk ka patur asnjë rast.; për nenet 186-196 të Kodit Penal janë regjistruar 5 procedime penale, kundrejt 12 të regjistruara në vitin 2018; për nenet 197-198 të Kodit Penal është regjistruar 1 procedim penal, po aq dhe në vitin 2018 dhe për nenet 199-200 të Kodit Penal është regjistruar 15 procedime penale, kundrejt 1 të regjistruara në vitin 2018. Për këtë vit është rritur dukshëm numri i procedimeve për kryerjen e veprës penale „Ndërtim i paligjshëm“, sipas nenit 199/a/1 të Kodit penal.

Pas këtij evidentimi duhen përmendur veprat penale që kanë të bëjnë me krime kundër autoritetit të shtetit, veprat penale kundër drejtësisë dhe ato që prekin zgjedhjet e lira respektivisht 60+1 të ardhura me transferim, gjithsej 61 procedime penale të detajuara si vijon: për nenet 235-247 të Kodit

Penal janë regjistruar 1 procedime penale, kundrejt 4 të regjistruara në vitin 2018; për nenet 248-260 të Kodit Penal janë regjistruar 6 +1 i ardhur me transferim,gjithsej 7 procedime penale, kundrejt 4 regjistruara në vitin 2018; për nenet 261-293/c,294-299 të Kodit Penal janë regjistruar 48 procedime penale, kundrejt 52 të regjistruara në vitin 2018 dhe për nenet për nenet 300-324/a, të K.Penal janë regjistruar 4 procedime penale kundrejt 3 të regjistruara në vitin 2018.

Për nenent 325-332/a të K.Penal është regjistruar 1 procedime penale,sipas statistikës vjetore,pavarësisht se paraprakisht kanë qenë regjistruar 3 procedime të cilat janë bashkuar në një procedim të vetëm në vitin 2019.

Veprat penale të drejtuara kundër shëndetit dhe jetës së personit. Rezulton se për vitin 2019 janë regjistruar 26(31 procedime penale + 1 ardhur me transferim,gjithsej 27 procedime ndërsa në vitin 2018 janë regjistruar gjithsej 32 procedime e konkretisht të ndara sipas grup veprave .

Për nenet 76-84/a të Kodit Penal janë regjistruar 6 procedime penale + 1 ardhur me transferim,gjithsej 7 procedime, kundrejt 8të regjistruara në vitin 2018; për nenet 86-90 të Kodit Penal janë regjistruar 4 procedime penale, kundrejt 11 të regjistruara në vitin 2018; për nenet 93-99 të Kodit Penal janë regjistruar 6 procedim penal,kundrejt 1 procedimi të regjistruar në vitin 2018.; për nenet 109-112 të Kodit Penal është regjistruar vetëm 1 procedim penal; për nenet 113-123 është rëgjistruar vetëm një procedim penal ndërsa në vitin 2018 nuk ka patur asnjë;për nenet 127-130/a/4 të Kodit Penal janë regjistruar 8 procedime penale kundrejt 12 të regjistruara në vitin 2018.

Një tendencë në rritje ka patur kryerja e veprave penale kundër mjedisit të parashikuar nga nenet 201-207 të Kodit Penal (prerje e paligjshme e pyjeve dhe shkatërrim me zjarr i pyjeve) ku evidentohen 7 raste kundrejt 2 rasteve në vitin 2018.

Duke iu referuar të dhënave të sipërpërmendura, vihet re se vepra penale e vjedhjes ,parashikuar nga neni 134 i Kodit penal është në të njejtin nivel si dhe një vit më parë.Ndërsa për sa i përket zbulueshmërisë së autorëve të kryerjes së veprës penale është shumë e ulët ,pothuajse fare vetëm me 1 autor,por përsëri vepra penale e vjedhjes mbetet një fenomen mjaft problematik për rrethin e Matit dhe që duhet të jetë në vijim në fokus të profesionistëve të kriminalistikës.

Evidentohet një tendence në rënie e çështjeve penale të regjistruara për nenin 290 të Kodit Penal (aksidenteve automobilistike), ku për vitin 2019 janë regjistruar vetëm 3 raste kundrejt 7 procedime penale të regjistruara gjatë vitit 2018.

Por përsëri mbetet Problematike ,megjithëse në vitin 2019 shënon një rënie çështjet penale që lidhen me “Drejtimit e automjetit në mënyrë të parregullt“ ,parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal,në vitin 2019 janë regjistruar 16 çështje kundrejt 20 të regjistruara në vitin 2018.

Rezulton se për nenin 199/a të Kodit Penal që parashikon veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm“ ,në vitin 2019 ka shënuar rritje të theksuar regjistrimi i procedimeve penale për këtë vepër,regjistruar gjithsej 15 procedime ndërsa në vitin 2018 nuk ka patur të regjistruar asnjë rast.

Gjithashtu problematike në vitin 2019 kanë qenë veprat penale të drejtuara kundër autoritetit të shtetit,grupi i veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike e konkretisht vepra penale e „kultivimit të bimëve narkotike“,parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal që në vitin 2019 shënon 9

procedime të regjistruar nga të cilat 2 janë bashkuar dhe sipas statistikës vjetore rezultojnë 7 procedime të regjistruara ndërsa në vitin 2018 nuk ka patur asnjë rast .

Gjithashtu një trend në rritje ka patur dhe vepra penale e „Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve...“,parashikuar nga Neni 278 i Kodit Penal pasi në këtë vit janë regjistruar 9 procedime penale kundrejt 5 procedimeve të regjistruara në vitin 2018.

Në vitin 2019 është regjistruar një rast i vetëm për veprën penale të“Vjedhjes me armë“,parashikuar nga Neni 140 i K.Penal,vepër e cila ka një impakt shumë negativ në komunitet pasi rrit frikën dhe pasigurinë e tij.

Gjithashtu në vitin 2019 ka patur një rritje të veprës penale“Shkaktimit të vetëvrasjes“,parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal,ndërsa grup veprat penale të vrasjes në vitin 2019 ka patur një ulje të tyre,këtë e tregon dhe fakti pasi në vitin 2019 është regjistruar vetëm 1 rast për nenin 78/1 të K.Penal,kundrejt 4 procedimeve të regjistruara në vitin 2018.

III- ANALIZA KRAHASIMORE 2 VJEÇARE E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

3.1 Në vitin 2019 janë regjistruar rishtazi në regjistrin e njoftimit të veprave penale gjithsej 177 procedime penale, me 47 persona nën hetim dhe 75 të pandehur nga të cilët 43 me masë sigurimi.

3.2 Ndërsa në vitin 2018 janë regjistruar rishtazi në regjistrin e njoftimit të veprave penale gjithsej 172 procedime penale me 38 persona nën hetim dhe 74 të pandehur, nga të cilët 48 me masë sigurimi personal.

3.3 Gjatë vitit 2019 janë hetuar gjithsej 220 procedime penale me 50 persona nën hetim dhe 81 persona të marrë si të pandehur, nga të cilët 48 me masë sigurimi personal. Këtu përfshihen procedimet e mbartura, të rifilluara dhe të ardhura me transferim.

3.4 Ndërsa gjatë vitit 2018 janë hetuar gjithsej 213 procedime penale me 40 persona nën hetim dhe 84 persona të marrë si të pandehur, nga të cilët 53 me masë sigurimi personal. Këtu përfshihen procedimet e mbartura, të rifilluara dhe të ardhura me transferim.

3.5 Për vitin 2019 janë dërguar për gjykim 65 çështje me 82 të pandehur, nga të cilët 32 me masë sigurimi;në krahasim dhe me vitin 201 si dhe krahasuar me një vit më parë numri i çështjeve të dërguara në gjyq ka qenë më pak ,por numri i personave për të cilët është ngritur akuzë dhe marrë si të pandehur pothuajse është i njëjtë me të një viti më parë.

3.6 Ndërsa në vitin 2018 janë dërguar për gjykim 71 çështje penale me 83 të pandehur, nga të cilët 37 me masë sigurimi personal.

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË MAT PËR VITIN 2019

4.1 Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat 65 çështje me 82 të pandehur, nga të cilët 37 me masë sigurimi personal.

Gjatë vitit 2019 pas dërgimit të procedimeve penale për gjykim (përfshirë këtu edhe dosjet e mbartura në gjykim nga viti 2018) ka përfunduar gjykimi gjatë vitit 2019 për 67 procedime penale me 71 të pandehur nga të cilët 30 me masë sigurimi personal. Janë mbartur për gjykim 27 procedime penale me 43 të pandehur, 16 prej të cilëve me masë sigurimi personal.

4.2 Të dhëna për gjykimet e posaçme

Gjatë vitit 2019, nga 67 çështje me 71 të pandehur është zhvilluar gjykim i zakonshëm për 21 procedime me 22 të pandehur, gjykim i shkurtuar për 35 procedime me 38 të pandehur, gjykim i drejtpërdrejtë për 11 procedime me 11 të pandehur nga këto 2 të mbartura në gjykim ,gjykim në mungesë për 2 procedime me 2 të pandehur. Gjykata ka disponuar pothuajse në të njëjtën mënyrë.

VITI	GJYKIM I DREJTPËRDREJTË		GJYKIM I ZAKONSHËM		GJYKIM I SHKURTUAR		GJYKIM NË MUNGESË		SHUMA	
	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur
2019	9	9	21	22	35	38	2	2	67	71

Për sa sipër prokurori Abaz Muça për periudhën raportuese veç sa sipër ,ka mbuluar edhe detyrën e prokurorit të ekzekutimeve të vendimeve penale gjyqësore si dhe ka përfaqësuar organin e akuzës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat në gjykimin e kërkesave të të dënuarve pranë I.E.V.Penale Burrel për lirimin me kusht sipas Nenit 64 e 59 të K.Penal e konkretisht.

Pjesëmarrja në Gjykim për lirim parakohe me kusht në 17 raste.Në 1 raste është pranuar kërkesa e të dënuarve për lirim me kusht nga ana e Gjykatës Mat ,nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Pjesëmarrja në gjykim e çështjeve të vecanta penale si përlllog.burgimi 7 raste,,përfitim nga L.A në 4 raste,kërkesa për mbikqyrje të veçantë në 2 raste ,bashkime dënimesh 6 kërkesa,lejim përgjimi,zgjatje afati lejim përgjimi janë 77 kërkesa të bëra nga prokurori,deklarim ikje 4 kërkesa,qëndrime në shtëpi në 6 raste,ankim kundra vendimeve të prokurorit ka marrë pjesë në 26 raste,revokime vendim pezullimi në 10 raste,caktim mase mjeksore dhe rivlersim mase mjeksore në 10 raste.

4.3 Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve

Siç u relatua më sipër, për vitin 2019, sipas të dhënave statistikore ka përfunduar gjykimi në gjykatë për 67 çështje me 71 të pandehur. Në varësi të llojit të veprave penale, sanksioneve përkatëse, rrezikshmërisë së tyre dhe të pandehurve, shkallës së fajit dhe rrethanave lehtësuese e rënduese janë bërë dhe kërkimet e prokurorit për llojin dhe masat e dënimit.

Nga Prokurori është kërkuar deklarimi fajtor për 62 të pandehur,dënim me burgim për 62 të pandehur nga të cilët 1 i pandehur me burgim të përjetshëm 2 të pandehur në në kufijtë pranë minimumit të dënimit, 30 të pandehur në kufijtë mesatarë të dënimit, për 2 pandehur në kufirin maksimal të dënimit dhe në një rast me paraburgim ndërsa për 26 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim (referuar nenit 59 të Kodit Penal).

Dënimi me gjobë është kërkuar për 7 të pandehur,për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 84,150,151,134,242,320 të K.Penal.

Pushimi i çështjes është kërkuar vetëm në 4 raste dhe gjykata ka vendosur për 3 raste.

Nga ana e Gjykatës në lidhje me kërkesat e bëra nga Prokuroria që parashtroam më sipër është vendosur deklarimi fajtor për 58 të pandehur (nga 62 të kërkuara nga Prokuroria).

Nga Gjykata është vendosur: Dënimi me burgim për 58 të pandehur nga të cilët 4 të pandehur në kufijtë e minimumit të dënimit, 27 të pandehur në kufijtë e dënimit mesatar, asnjë në kufijtë maksimalë të dënimit, 1 me burgim të përjetshëm dhe për 24 të pandehur ka aplikuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim (referuar nenit 59 të Kodit Penal).

Dënimi me gjobë është dhënë për 7 të pandehur aq sa është kërkuar nga prokuroria .

Gjatë vitit 2019 Gjykata ka deklaruar 1 rast të pafajshëm për veprën penale „Shpërdorim detyre“parashikuar nga neni 248 i K.Penal.Nga ana e prokurorit është bërë ankim çështja është në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.Në këtë rast shkaku i pafajsisë qëndron në atë pasi procedimi penal sa sipër është regjistruar sipas urdhërimeve të Gjykatës mbi shquqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal,ankimuar nga kallzuesi dhe regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale është dërguar për pushim dhe nga ana e gjykatës është urdhëruar të formulohet akuza dhe të dërgohet për gjykim.

Krahasuar me vitin2018, numri i çështjeve të gjykuara në vitin 2019 është më i lartë,me 16 çështje më shumë.

VITET	SHUMA	
	Çështje	Të pandehur
2018	51	62
2019	67	71

4.4 Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si: gjinia, mosha, arsimi, punësimi, etj.

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri i personave të mitur që kryejnë vepra penale nuk është shumë i lartë. Kështu rezulton se janë regjistruar si autorë të veprave penale 4 persona të mitur, 2 meshkuj dhe 2 femra Si zakonisht në më të shumtën e rasteve të evidentuara veprat penale kryhen nga të rriturit dhe në të shumtën e rasteve nga meshkujt. Nga 65 persona të rritur, autorë të veprave penale, vetëm 3 prej tyre janë femra.

Në përgjithësi ka një raport jo të drejtë në nivelin e arsimit të personave autorë të veprave penale. Kështu evidentohet se 40 persona janë me arsim 8-vjeçar dhe 23 të tjerë janë me arsim të mesëm dhe 3 me arsim të lartë dhe 53 prej tyre janë të papunë. Vetëm një pjesë e vogël janë të punësuar apo të vetëpunësuar.

Evidentohet se shumica e personave që kryejnë vepra penale banojnë në zonat rurale dhe pjesa tjetër në qytet. Kështu sipas statistikave, 38 autorë të veprave penale banojnë në fshat dhe 25 banojnë në qytet.

4.5 Të dhëna për të pandehurit e mitur (numri i procedimeve të regjistruara)

Gjatë vitit 2019, janë regjistruar 6+ të mbartura, procedime penale me 8 persona të mitur të mitur në hetim, ku pas kryerjes së veprimeve të para ,procedimet me autorë të mitur 3 raste janë dërguar për miratim dërgimi në gjyq dhe nga ana eGjykatës është vendosur pranimi i kërkesës për dërgim ceshtje në gjyq për 2 raste dhe një kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq mbartet në vitin pasardhës.Nga 2 raste që është miratuar kërkesa vetëm 1 rast është gjykuar më burg në aplikim të nenit 59 të K.Penal dhe 1 rast mbartet në gjykim,ndërsa në 4 raste është deklaruar moskompetenca dhe aktet i kanë kaluar për kompetencë hetimi prokurorisë kopetente dhe 1 rast mbartet në hetim .

4.6 Të dhëna për pasojat e veprave penale

Sa u përket të dhënave lidhur me pasojat e veprave penale, sipas statistikave rezulton se për vitin 2019 ka patur 2 raste të plagosjes së rëndë . Janë regjistruar 8 raste vdekje për shkak të veprave penale e konkretisht 2 raste vdekje personi si pasojë e veprës penale „Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor“,parashikuar nga neni 290 i K.Penal dhe „Shkaktimit të vetëvrasjes“,parashikuar nga neni 99 i K.Penal në 6 raste.

V. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

5.1 Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë), njohje vendimi, transferim procedimi, ekzekutim letër porosie, etj.

Nga të dhënat e verifikuara rezulton se gjatë vitit 2019 nuk është kryer asnjë procedurë ekstradimi për jashtë shtetit apo nga jashtë të personave të pandehur.Ka patur disa raste sporadike të letër porosive nga jashtë shtetit, në përgjithësi për njoftim të akteve të personave të dënuar. Gjithashtu nuk ka patur asnjë kërkesë për njohje të vendimeve të huaja penale.

VI. TË DHËNA PËR NGARKESËN E PUNËS PËR ÇDO PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

6.1 Ngarkesa specifike e punës për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat gjatë vitit 2019 ka funksionuar me dy prokurorë deri në muajin Shtator të vitit 2019 dhe më pas me një prokuror dhe dy oficerë të policisë gjyqësore. Me këtë kapacitet mendojmë se janë përmbushur më së miri detyrimet ligjore të organit të akuzës së Matit, duke marrë në konsideratë ngarkesën e secilit.

Kjo ngarkesë pune paraqitet si më poshtë:

Prokurori Hysni Vata. Ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 39 procedime penale të regjistruara,7 të mbartura nga viti 2018 dhe 2 të rifilluara,48 në total. Ka dërguar për gjykim 17 procedime, ka vendosur pushimin për 14 procedime, ka pezulluar hetimet për 14 procedime ,për 1 procedim ka vendosur transferimin.

Gjithashtu prokurori Hysni Vata ka vendosur mbi mosfillimin e procedimit për 53 raste

Prokuori Abaz Muça. Ka drejtuar, kontrolluar dhe ndjekur hetimet për 138 procedime penale të regjistruara, 10 të mbartura nga viti 2018 dhe 28 të rifilluara në total 176 procedime. Ka dërguar për gjykim 48 procedime, ka vendosur pushimin për 60 procedime 28 prej të cilave të rifilluara, 6 procedime të transferuara, ka pezulluar hetimet për 44 procedime, 18 procedime mbetet në hetim.

Gjithashtu prokurori Abaz Muça ka vendosur mbi mosfillimin e procedimit për 97 raste

Tabela në vijim pasqyron ngarkesën e prokurorëve me ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim gjatë vitit 2019.

Prokurorët	Hetime totale	Procedime të Përfunduara	Gjykime	Pezullime	Pushime	Transferime	Mbartur
H.Vata	46+3 Rifill=49	49	17	14	14+3=17	1	0
A.Muça	148+28 Rifill=176	158	48	44	32+28=60	6	18
TOTALI	194+31Rifill=225	207	65	58	46+31=77	7	18

Hetimi për vitin 2019 është mbuluar nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë dhe nga oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë e të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Përgjithësisht, delegimi i procedimeve penale është bërë sipas sugjerimit që kanë bërë Komisarati i Policisë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, duke u deleguar procedimet oficerëve që kanë referuar materialin dhe kanë kryer veprimet kryesore proceduriale dhe hetimore. Në disa raste sugjerimi për delegim është bërë për oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit që mbulojnë zonën ku ka ndodhur vepra penale.

Oficerët e policisë gjyqësore të strukturës pranë Prokurorisë Artan Ballabani, Isak Hoxha për vitin 2019 kanë përballuar ngarkesë të konsiderueshme materiale dhe procedimesh penale, duke e llogaritur peshën në % janë hetuar 44.85% të çështjeve nga of.pol.gjyqësore të Prokurorisë. Përgjithësisht, oficerët e policisë gjyqësore të strukturës pranë Prokurorisë kanë kryer veprimet verifikuese për shumicën e materialeve në fazën verifikuese si dhe kanë ndjekur në hetim procedimet penale të regjistruara mbi kallëzimet e qytetarëve dhe procedime të tjera të referuara nga policia.

Por, gjatë vitit 2019, oficerët e policisë gjyqësore të strukturës së Prokurorisë krahas me hetimin janë ngarkuar edhe me detyra të tjera sipas nevojave që ka diktuar puna në sektorë të ndryshëm të Prokurorisë, psh.: me mbajtjen e Regjistrit të ekzekutimeve dhe në ndjekjen e ekzekutimeve të vendimeve penale, mbajtjen e dosjeve dhe ekzekutimeve penale si dhe angazhimin në kthim përgjigje të shkresave të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme për subjektet e rivlersimit, subjekteve që zgjidhen apo emërohen etj.

Puna e policisë gjyqësore e strukturës pranë Prokurorisë dhe e atyre pranë Komisarariatit të Policisë Mat dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, vlerësohet pozitivisht, jo vetëm për dokumentimin e mirë të veprave penale, por edhe për hetimin me shpejtësi e pa zvarritje të procedimeve penale.

Tabela më poshtë pasqyron ngarkesën e oficerëve të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë për vitin 2019.

O.P.GJ	Hetuar	Pezullime	Pushime	Transferime	Gjykime	Hetim
I.Hoxha	19+4 mbartura =23	5	12	0	4	2
A.Ballabani	56+8 mbartura=64	5	18	4	35	2
Totali	87	10	30	4	39	4

Kërkesat paraprake

Vlen të përmendim dhe ndryshimet e fundit të Ligjit penal,të cilin Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat e ka zbatuar me përpikmëri për sa vijon.

➤ Dërguar Gjykatës për pushim çështje ose akuze 60 procedime me 16 persona nën hetim,gjykata ka vendosur në 42 ka pranuar pushimin e procedimit,në 1 rast ka kthyer aktet .

➤ Dërguar Gjykatës për miratim urdhëri penal 2 çështje me 2 të pandehur,nga na a e gjykatës janë miratuar të 2 rastet.

➤ Dërguar Gjykatës për miratim marrëveshje në vitin 2019 nuk kemi patur asnjë rast.

➤ Dërguar në seancë paraprake kërkesa për gjykim 73 çështje me 92 të pandehur,nga ana e Gjykatës Mat është miratuar kërkesa për dërgim ne gjyq për 63 çështje dhe ,2 pushuar dhe 1 rast kthim aktesh,mbarten 26 raste për vitin 2020.

6.2 Ushtrimi i rolit dhe kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë:

Roli i drejtuesit të prokurorisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe organizimin e punës në prokurori dhe jo vetëm,si ndjekja e ecurisë së hetimit dhe problematikat e hasura, si dhe i krijimit të marrëdhënieve me Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë, e seksioneve dhe shërbimeve të Policisë si dhe me institucione të tjera.

Gjatë periudhës që analizojmë nga Drejtuesit e Prokurorisë ka ushtruar studimin e të gjitha materialeve kallëzuese dhe të referuara nga Policia Gjyqësore e ato me vendngjarje, duke marrë masa për shpërndarjen e tyre në bazë të shortit në Sistemin CAMS deri në momentin që mbeti një prokuror i vetëm më pas është vepruar manualisht.

Urdhrat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm janë punuar dhe diskutuar për zbatimin e tyre.

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat ka në strukturën e saj 3 prokuror,2 oficer të policisë gjyqësore,1 k/sekretar,1 sekretar ,1 kordinator dhe 1 shofer.

Kjo strukturë organike megjithse numrin e prokurorëve e ka 3 ,por në fakt në këtë prokurori deri në muajin Shtator të vitit 2019 ka patur dy prokuror funksionalë dhe pas këtij muaji ka qenë vetëm një prokuror i cili është i komanduar drejtues i cili ka përbaluar hetimin,gjykimin dhe çështje të tjera administrative.

Në mbarëvajtjen e punës të veprimtarisë së Prokurorisë, një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e Prokurorisë. Rezulton tashmë një evidencë e saktë dhe e qartë që nga momenti i protokollimit të materialeve në kryesekretari e më pas në regjistrat e kallëzimeve, procedimeve penale, të mosfillimeve, të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, etj mbajtur nga k/ sekretaria.

Të gjitha materialet kallëzese janë regjistruar në sistemin CAMS duke operuar me kujdes në këtë sistem për të pasqyruar saktë të dhënat përkatëse në bashkëpunim dhe me strukturën përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Po nga Kryesekretaria janë evidentuar me korrektësi shpenzimet proceduriale të çështjeve penale të parapaguara nga shteti e të mbajtur nga prokurorët. Gjithashtu është mbajtur evidencë e saktë në lidhje me pagesat honorare për vitin 2019. Janë shlyer detyrimet për ekspertë autoteknikë, mjekoligjor, avokatë, përkthyes, teknikë vlerësues, ekspertë kontabël, MZSH në shumën 903500 lekë. Shpenzime të mbartura për 2020 për avokatë, ekspertë, mjeko-ligjorë, përkthyes, etj nuk ka.

Në kuadër të zbatimit të V.K.M Nr.591, datë 23.07.2010 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore" nga ana jonë po bëhen përpjekje për një menaxhim sa më optimal të këtyre fondeve.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar respektimit të disiplinës në punë dhe etikës nga punonjësit e prokurorisë. Është ushtruar kontrolli i brendshëm për zbatimin e tyre dhe në raste të caktuara të mosrespektimit janë marrë dhe masa duke tërhequr vërejtje . Kodi i Etikës parashikon standarde të qarta dhe të detyrueshme sjelljeje për prokurorët, në thelb të të cilave qëndron detyrimi që ata të veprojnë në përputhje me të drejtat e njeriut dhe efektivitetin e drejtësisë penale.

VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur në analizë të tyre duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin 2020 në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

Ndër drejtimit e kryesore të punës duhen vlerësuar:

Së pari, një ndër drejtimit kryesore të veprimtarisë së punës për vitin 2020 është ngritja e cilësisë së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve penale. Cilësia në veprime pasqyron së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe Oficeri të Policisë Gjyqësore, duke e pasqyruar atë në përpilimin e akteve, formulimin dhe arsyetimin ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare si dhe përfaqësimit në Gjykatë.

Së dyti, duhet rritur ndjeshëm kontrolli në dinamikë nga ana e Prokurorëve gjatë hetimeve paraprake të çështjeve, duke mos u mjaftuar me nxjerrjen e një urdhri për kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri në ardhjen e akteve nga shërbimet dhe Seksionet e Policisë Gjyqësore, duke shkaktuar vonesa në hetim, humbjen e aktualitetit të një veprimi hetimor që mund të rezultojë gjatë dinamikës, etj. Në dinamikë gjatë kontrollit të veprimtarisë hetimore nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, Prokurori duhet të jetë jo vetëm një orientues i veprimeve hetimore apo të nxjerrë akte proceduriale për veprime specifike si kontrole, përgjime, etj, por duhet të jetë dhe iniciues, apo nxitës për një hetim sa më dinamik, të shpejtë, të një hetimi të zgjeruar për të gjitha problematikat. Duhet të evidentojë konkretisht dhe përcjellë me informacione Drejtuesit e Prokurorisë problematika të veçanta, pengesa të ndryshme qoftë që kanë të bëjnë dhe me mënyrën e funksionimit të organizimit të punës së veprimtarisë hetimore, siç janë zvarritjet e pajustificueshme, etj.

Së treti, për çështje të veçanta për shkak të rrezikshmërisë shoqërore, apo përhapjes së një krimi, duke iu referuar tendencës së kriminalitetit, aq më tepër për çështje të rënda dhe sensitive duhet bërë vlerësimi i diferencuar, duhet kryer analiza e vlerësimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lënë detyra konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore.

Marrja kontakt që nga momentet e para nga prokurori me të dyshuarin (arrestuarin/hetuarin/pandehurin) krijon një perceptim më të drejtë në lidhje me hetimet që do të kryhen më pas, shmang dhe probleme procedurale në lidhje me zgjedhjen e masës shtrënguese të marrë nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, si dhe për krijimin e një politike të drejtë të kërkesës për masë sigurimi, bazuar dhe në personalitetin e të dyshuarit, etj.

Në prioritetet për vitin 2020 në vazhdim:

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur në analizë të tyre duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin 2020 e në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

Së pari :Në luftën kundër korrupsionit!Evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara, apo evidentuara kryesisht që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore apo private. Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicie për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndihet një shqetësim i përgjithshëm i komunitetit.

Së dyti: Në luftën krimit të organizuar në veçanti dhe ulja e nivelit të kriminalitetit në përgjithësi! Kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, por edhe me faktorë të tjerë, ku duhen përmendur veprat penale kundër, kundër autoritetit të shtetit dhe korrupsionit sidomos ato vepra penale që kanë impakt negativ në komunitet si „Kultivimi i Bimëve narkotike“ duke e minimizuar apo zeruar, duke rritur rastet e hetimeve proaktive dhe veprimeve simuluese.Gjithashtu duhet punuar më tepër nga o.p.gj-re për zbulueshmërinë e veprave penale sidomos atyre në sferën ekonomike pasi zbulueshmëria për këtë vepër penale është në nivelin minimal.

Së treti: Rifillimi i çështjeve të pezulluara sipas nenit 326 të Kodit të Procedurave Penale, për veprat penale të rënda, siç janë vrasjet e pazbuluara, të cilat rezultojnë në një numër të konsiderueshëm të pezulluara dhe të relatohen për rifillim hetimesh.

Së katërti :Trajnimi i Of.pol.Gjyqësore dhe rritja e aksesimit në Sistemin CAMS duke rritur vëmendjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në përdorimin e sistemit të Menaxhimit të Çështjeve .

Analizës i bashkëlidhen edhe tabelat përkatëse me treguesit statistikorë 2 vjeçarë.



DREJTUESI I PROKURORISË

Abaz MUÇA

PËRMBLEDHËSE

Aktiviteti i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat karakterizohet nga këta tregues performance për vitin 2019.

- Janë regjistruar 341 materiale kallëzuese kundrejt 363 materialeve kallëzuese të regjistruara në vitin 2018.
- Nga 363 materiale kallëzuese është vendosur mosfillimi për 120 +30 =150 kallëzime penale të vitit 2019 krahasuar me 147 +44=191 referime të mosfilluara gjatë vitit 2018.
- Janë ndjekur gjithsej 225 procedime penale, nga 219 tw ndjekuar gjastw vitit 2018.

Tabela në vijim pasqyron ngarkesën e aktivitetit penal të Prokurorisë Mat të ndarë sipas destinacionit të çështjeve dhe prokurorëve përgjegjës për ndjekjen e tyre.

Prokurorët	Hetime totale	Procedime të Përfunduara	Gjykime	Pezullime	Pushime	Transferi me	Mbartur
H.Vata	46+3 Rifill=49	49	17	14	14+3=17	1	0
A.Muç	148+28 Rifill=176	158	48	44	32+28=60	6	18
TOTALI	194+31Rifill=225	207	65	58	46+31=77	7	18

Krahasimi i statistikave të dy viteve të fundi

Vite t	Kallëzime të regjistruara	Procedime të mbartura	Procedime të regjistruara	Rifilluar	Ardhur me Transferi	Ndjekur procedurat në hetim
2018	363	23	166	24	6	219
2019	341	17	172	31	5	225

Nga 225 procedime të vitit 2019 u është dhënë zgjidhje 207 procedimeve, me 33 persona nën hetim, 82 të pandehur dhe 39 me masw sigurimi personal, si vijon:

- **Mbartur:** 17 procedime nga viti 2018 me 4 persona nën hetim, 7 të pandehur dhe 6 të arrestuar, kundrejt 23 procedimeve të mbartura në vitin 2018.
- **Pushime:** 77 procedime penale me 25 persona nën hetim 4 nga tw cilwt me masw sigurimi personal, janë pushuar në vitin 2019 krahasuar me 66 procedime penale me 22 persona nën hetim të pushuara gjatë vitit 2018
- **Pezullime:** 58 procedime janë pezulluar gjatë vitit 2019 kundrejt 50 procedime penale të pezulluara gjatë vitit 2018.
- **Transferime:** Janë transferuar 7 procedime penale me 7 persona nën hetim, 4 me masw sigurimi personal, kundrejt 15 procedime në vitin 2018, pra 8 procedime me pak.

- **Gjykime:** Gjatë vitit 2018, wshtw vendosur dërgimin në gjykatë për 65 procedime me 82 të pandehur dhe 32 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Krahasuar me vitin 2018, gjatë të cilit u dërguan në gjykim 71 procedime penale me 83 të pandehur, 37 prej të cilëve me masë sigurimi personal, rezultojnë 6 çështje më pak se në vitin 2018, por numri i të pandehurve pothuajse wshtw i njëjtë.
- **Vendime gjykate:** Janë gjykuar gjithsej gjatë vitit 2019 saktësisht 67 çështje penale me 71 të pandehur, 30 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Ndërkohë gjatë vitit 2018 janë gjykuar 51 çështje penale me 62 të pandehur, 34 prej të cilëve me masë sigurimi personal. Siç dhe shihet janë 16 çështje më shumë të gjykuara në vitin 2019.

Masa Sigurimi personal:

- Gjithashtu janë paraqitur në Gjykatë 43 kërkesa për caktimin e masave të sigurimit personal, nga të cilat 22 prej tyre me "Arrest në burg", 9 me "Arrest në burg në mungesë", 1 "Arrest në burg me afat", 6 "arrest në shtëpi", 5 persona me "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore".

Mbeten në hetim për vitin 2019

- 18 procedime me 18 persona nën hetim nga të cilët 9 persona me masa sigurimi personal.

Janë gjykuar gjatë vitit 2019

- 67 çështje me 71 të pandehur nga të cilët 33 persona me masa sigurimi personal.
- mbeten në gjykim 27 procedime me 43 të pandehur, nga të cilët 16 persona me masa sigurimi personal.

Janë ekzekutuar 51 vendime penale të formës së prerë dhe jo vetëm. Nga këto:

- 28 vendime kanë patur disponim me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim
 - 3 vendime kanë patur disponim me dënim me gjobë
 - 11 vendime kanë patur disponim me dënim me burgim
 - 4 vendime kanë patur disponim për lirim para kohe me kusht
 - 5 vendime kanë patur disponim për pezullimin e ekzekutimit me burgim e detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik
- Gjithashtu janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi për:
- 2 vendime kanë patur disponim rivlerësim e caktim mase mjekësore
 - 30 vendime kanë patur disponim për shpenzimet proceduriale
 - 5 vendime kanë patur disponim për kthim prove materiale

Vlen të përmendim dhe ndryshimet e fundit të Ligjit penal, hyrë në fuqi me datë 01.08.2017, të cilin Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat e ka zbatuar me përpikmëri për sa vijon.

- Dërguar Gjykatës për pushim çështje ose akuze 60 procedime me 16 persona nën hetim, gjykata ka vendosur në 42 ka pranuar pushimin e procedimit, në 1 rast ka kthyer aktet .
- Dërguar Gjykatës për miratim urdhëri penal 2 çështje me 2 të pandehur, nga ana e gjykatës janë miratuar të 2 rastet.
- Dërguar Gjykatës për miratim marrëveshje në vitin 2019 nuk kemi patur asnjë rast.
- Dërguar në seancë paraprake kërkesa për gjykim 73 çështje me 92 të pandehur, nga ana e Gjykatës Mat është miratuar kërkesa për dërgim në gjyq për 63 çështje dhe ,2 pushuar dhe 1 rast kthim aktesh, mbarten 26 raste për vitin 2020.

Prioritetet e Punës së Prokurorisë Mat për vitin 2020 në vazhdim:

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur në analizë të tyre duhet të evidentojmë dhe drejtimet kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin 2020 e në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

Së pari :Në luftën kundër korrupsionit! Evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara, apo evidentuara kryesisht që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore apo private. Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicie për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndihet një shqetësim i përgjithshëm i komunitetit.

Së dyti: Në luftën krimit të organizuar në veçanti dhe ulja e nivelit të kriminalitetit në përgjithësi! Kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, por edhe me faktorë të tjerë, ku duhen përmendur veprat penale kundër, kundër autoritetit të shtetit dhe korrupsionit sidomos ato vepra penale që kanë impakt negativ në komunitet si „Kultivimi i Bimëve narkotike“ duke e minimizuar apo zëruar, duke rritur rastet e hetimeve proaktive dhe veprimeve simuluese. Gjithashtu duhet punuar më tepër nga o.p.gj-re për zbulueshmërinë e veprave penale sidomos atyre në sferën ekonomike pasi zbulueshmëria për këtë vepër penale është në nivelin minimal.

Së treti: Rifillimi i çështjeve të pezulluara sipas nenit 326 të Kodit të Procedurave Penale, për veprat penale të rënda, siç janë vrasjet e pazbuluara, të cilat rezultojnë në një numër të konsiderueshëm të pezulluara dhe të relatohen për rifillim hetimesh.

Së katërti :Trajnimi i Of.pol.Gjyqësore dhe rritja e aksesimit në Sistemin CAMS duke rritur vëmendjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në përdorimin e sistemit të Menaxhimit të Çështjeve.



DREJTUESI I PROKURORISË

Abaz MUÇA